



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

5313
Nr. Prot

Roskovec, më 03.12.2024

Lënda: Mbi kërkesën për Deklaratë në Lidhje me Incidentin në Bashkinë e Roskovecit

SAFEJOURNALISTS NETWORK

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion ardhur në email-in zyrtar të Kryetarit të Bashkisë Roskovec, ju informojmë si vijon:

Në datën 20 Nëntor, rreth orës 09:00 të mëngjesit Kryetarja e bashkisë Roskovec, si cdo ditë ka ardhur në bashki dhe ka zbritur nga makina në pjesën e garazhit të bashkisë, aty ku cdo ditë qëndron makina.

Pjesa e garazhit të bashkisë është e lidhur me pjesën e magazinës, ku ka bazë materiale me vlerë monetare. Menjëherë dy persona të pidentifikuar me mjete identifikuese dhe pa paraqitur asnjë letërnjoftim për identitetin e tyre kanë hyrë forcërisht në këto ambiente ku nuk lejohen qytetarë (për shkak edhe të magazinës).

Nga policia bashkiake (shefi i policisë bashkiake i pajisur me mjet identifikues (bexha) janë lutur që të dalin jashtë garazhit dhe të paraqiten në zyrën e informacionit (zyra me një ndalesë) në katin e parë të bashkisë Roskovec. Edhe nga ana e Kryetares së bashkisë është kërkuar mjet identifikues për cilësinë që dy personat pretendojnë por nuk është paraqitur asgjë. Po ashtu dhe nga Kryetarja e bashkisë janë sqaruar që duhet të paraqiten në zyrën e informacionit të bashkisë Roskovec.

Bashkia Roskovec, ashtu sikurse cdo institucion tjetër funksionon në bazë të ligjeve, akteve nënligjore dhe rregullave të përcaktuara në akte të brendshme të bashkisë (urdhëra dhe vendime) dhe të bërë publike në faqen zyrtare (web) të bashkisë Roskovec.

Nuk mund të abuzohet me të drejtën e informimit dhe as me cilësimin "Gazetar", duke dhunuar pronën publike dhe shkelur rregullat e vendosur për zbatim pasi në të kundërt nuk do të ishim një shtet ligjor i së drejtës.

Ligjvënësi ynë e ka sanksionuar të drejtën e informimit me anë të aktit ligjor Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, sipas të cilit citohet se: "Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet", dhe po ky ligj përcakton mënyrat e marrjes së informacionit dhe konkretisht në nenin 11 të tij citohet se: "**Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.**"

Ky informacion, si edhe mënyra e paraqitjes së kërkesës është e publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Roskovec në linkun: <https://bashkiaroskovec.gov.al/kerkesa-tip-per-informacion/>.

Po ashtu, me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec nr. 50, datë 19.02.2024 “Për miratimin e rregullores së brendshme të administratës së bashkisë dhe Njësisë Administrative në varësi Kuman, Kurjan dhe Strum”, janë përcaktuar rregullat e funksionimit të këtij institucioni, komunikimi me publikun dhe median, menyrat e hyrjes në institucion etj. Rregulloren e brendshme të institucionit e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Roskovec në linkun: <https://bashkiaroskovec.gov.al/rregullore-e-brendshme-e-bashkise-roskovec-2024/>.

Raste të tilla të qytetarëve të cilët pretendojnë se janë gazetarë por nuk denjojnë të paraqesin asnjë mjet identifikues apo letërnjoftim janë të shtuara. Po ashtu janë të shtuara edhe sjellje të cilat çënojnë rregullat e sjelles dhe etikës, rregullat e mbarëvajtjes së institucionit dhe aktet ligjore në fuqi si edhe pengojnë në ushtrimin e funksionit dhe detyrave të Kryetarit ose administratës së bashkisë.

Vetëm disa muaj më parë është përsëritur i njëjti rast, dy persona të paidentifikuar, hynë në ambientët e brendshme të institucionit duke refuzuar të përgjigjeshin policit të bashkisë mbi identitetin e tyre apo arsyen pse ndodheshin në institucion ose shërbimin që kërkonin të merrnin. Këta individ vetëm me një kamera dhe cilësinë “Gazetar” kanë hapur cdo zyrë të bashkisë dhe filmuar, kanë hyrë duke hapur dhe përplasur dyert. Për këtë rast bashkia Roskovec ka bërë denoncimin përkatës në Komisaratin e Policisë së Shtetit, Qarku Fier duke e shoqëruar atë me pamjet filmike të kamerave të sigurisë së institucionit.

Ne si institucion i mëshojmë fort transparencës dhe llogaridhënies por konform të gjitha rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Kushdo që kërkon një informacion apo një kërkesë mund ta paraqesë atë në zyrën me një ndalesë të bashkisë Roskovec (zyra e informacionit) e cila pasi trajtohet dhe mer zgjidhje i vendoset në dispozicion kërkuarit. Po ashtu, kjo kërkesë mund të paraqitet në email-in zyrtar të bashkisë Roskovec info@bashkiaroskovec.gov.al ose me postën fizike. Në cdo rast kërkesa trajtohet dhe merr përgjigje brenda afateve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Për më tepër, emisioni Piranjat e kanë një praktikë të njohur paraqitjen e kërkesës pranë bashkisë Roskovec pasi vetëm një muaj më parë kjo media ka bërë dy kërkesa për informacion dhe dokumentacion të paraqitur në email-in zyrtar të Koordinatorit për të drejtën e informimit dhe fizikisht me shkresë nisur me postë, në datën 16 Tetor, dhe Brenda afatit zyrtar kanë marrë përgjigje për informacionin e kërkuar me email dhe me postë, në përmbushje të plotë të detyrimeve ligjore. Pra, kur kërkesa bëhet conform ligjit Bashkia Roskovec shpreh gadishmërinë e plotë ta trajtojë atë.

Edhe kërkesa për intervistë me Kryetaren e bashkisë si çdo kërkesë tjetër do të trajtohet nga struktura përkatëse, do të koordinohet me axhendën e kryetares dhe do tju kthehet një përgjigje zyrtare për këtë kërkesë.

Shpresojë në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj që raste të tilla mos të bëhen abuzive duke shkelur mbi rregullat për të drejtën e informimit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

KRYETAR
Majlinda Bufi